

STATUTI I SHOQËRISË

“SONDATA” SHPK

TITULLI I

DATA E THEMELIMIT, EMËRTIMI, THEMELUESIT, FORMA E SHOQËRISË, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, ZYRA QËNDRORE, VULA E SHOQËRISË

NENI 1: Data e Themelimit, Emërtimi, Themeluesit.

- 1.1. Shoqëria “SONDATA” SHPK, krijohet në bazë të aktit të themelimit në datë 09/09/2025 nga ortaku i vetëm, **Z. Etiev Mane**, shtetas shqiptar, lindur më 10.05.1985 në Vajzë, Vlorë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, identifikuar me letër njoftimin ID me nr. 036493314 dhe nr personal I50510119C, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Neni 2: Personaliteti juridik

- 2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar
2.2 Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2.3 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese, Akt Themelimi dhe Statut.


Neni 3: Forma e Shoqërisë.

- 3.1 Shoqëria do të ketë formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, derisa me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme do të vendoset shndërrimi i formës ligjore.

Neni 4: Objekti i aktivitetit të Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose me pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti:

- Ofrimi i shërbimeve të konsulencës dhe organizimit të biznesit, konsulencës për implementimin e sistemeve informative dhe konsulenca teknologjike në sektorin informatik. Tregtimi i produkteve hardware e software.
- Operimi në sektorin e telekomunikacionit, telemarketing call center inbound dhe outbound duke kryer çdo lloj veprimtarie nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të tretëve me seli në Shqipëri apo në çdo vend tjetër që ka lidhje me Republikën e Shqipërisë, duke respektuar ligjin në fuqi.
- Tregtimi i shërbimeve të lidhur me publikimin dhe publicitetin në web.
- Të gjithë aktivitetet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe financiare të lidhura me objektin e shoqërisë.



- Shoqëria mund të ketë pjesëmarrje në formën e mbajtjes së aksioneve/kuotave apo interesave të tjera në shoqëri tregtare apo ndërmarrje me objekt veprimtarie që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5: Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria "SONDATA" SHPK kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

5.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe nga kjo datë mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6: Selia

6.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga e Dibrës, Kompleksi Arlis, Shk. 4, Nr. 7/6, Zona Kadastrale 8120, Tiranë, Albania.

6.2 Me miratim të organeve të saj, Shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

Neni 7: Vula e Shoqërisë

7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emërtimin ose initiale

TITULLI II

KAPITALI

Neni 8: Kapitali Themeltar

8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 500 000 (pesëqind mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortaku i vetëm;


Etiev Mane i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 500 000 (pesë qind mijë) Lekë duke i dhënë të drejtën e pjesëmarrjes 100% të kapitalit aksionar.

8.2 Kapitali është i ndarë në 1 (një) kuotë i zotëruar nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

8.3 Kapitali themeltar do të depozitohet në një nga Bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë.

Neni 9: Kuotat, të drejtat e lidhura me to.

9.1 Çdo kuotë i jep të drejtën e një vote për të marrë vendime sipas Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

 2

Neni 10: Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

10.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

10.2 Shumica e anëtarëve nuk mund të detyrojnë asnjë nga anëtarët e tjerë të rrisin pjesën e tyre në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

10.3 Zvogëlimi i kapitalit aksionar mund të vendoset vetëm nga asambleja e ortakëve, në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e këtij Statuti.

10.4 Në çdo rast, ulja e kapitalit duhet të bëhet në përpjesëtim me aksionet e secilit prej Aksionarëve.

Neni 11: Trasferimi i kuotave.

11.1 Aksionet e kapitalit të shoqërisë "SONDATA" SH.P.K. dhe të drejtat dhe detyrat e ndërlidhura mund të transferohen si më poshtë:

- a) Kontributit në kapitalin aksionar;
- b) Shitje dhe blerje;
- c) Trashëgimia;
- d) Dhurimi;
- e) dhe çdo negociatë tjetër të përcaktuar me ligj.

11.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në statutin e shoqërisë.

11.3 Pjesët e kapitalit themeltar kalohen me trashëgimi sipas ligjit në fuqi.

TITULLI III


ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 12: Organet vendimarrëse

12.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë. Asambleja e ortakëve është organi i vetëm që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve vendos për çështjet e mëposhtme:

- Vendimet për politikat ekonomike e tregtare të shoqërisë;
- Ndryshimet e Statutit;
- Emërimi dhe shkarkimi i administratorit.
- Emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat. c) dhe d);
- Mbikëqyrja e punës së kryer nga administratori, duke përfshirë kontrollin buxhetor dhe politikat e menaxhimit;
- Miratimi i pasqyrave financiare dhe raportet e ecures së veprimtarisë;
- Zmadhimi dhe zvogëlimin e kapitalit;

 3

- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedura të tjera kundër administratorit;
- Riorganizimi dhe likuidimi/prishja e shoqërisë;
- Miratimi i procedurave për thirrjen e Asamblesë;
- Çështje të tjera të kërkuara me ligj;

12.2 Anëtarë mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme nëpërmjet një autorizimi të lëshuar për një person të tretë ose për një nga anëtarët e tjerë;

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblesë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtën rend dite.

Neni 13: Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

13.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftimin nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike, duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për takimin.

13.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur duke respektuar procedurën e përshkruar më sipër, vendimet janë të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionarët janë dakord me rendin e ditës, edhe nëse vetë thirrja nuk është e vlefshme.

Neni 14: Kuorumi

14.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosi për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

14.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtën rend dite.


Neni 15: Marrja e vendimeve

15.1 Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrjes, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërive.

15.2 Çdo ndryshim statusi duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 16: Përjashtimi nga e drejta e votës

16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:



- Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

Neni 17: Administrimi

17.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë individë si Administrator të Shoqërisë. Emërimi nuk mund të zgjasë më shumë se pesë vjet dhe është i rinovueshëm. Emërimi i tyre mund t'u vendoset palëve të treta pasi të regjistrohen në Regjistrin e Përgjithshëm.

17.2 Administratori i shoqërisë "SONDATA" SHPK do të jetë:


Z. Etiev Mane, shtetas shqiptar, lindur më 10.05.1985 në Vajzë, Vlorë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, identifikuar me leter njoftimin ID me nr. 036493314 dhe nr personal I50510119C, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

17.3 Veprimet e administrimit të Shoqërisë përpara të tretëve do të konsiderohen të vlefshme nëse janë ndërmarrë dhe nënshkruar nga Administratori i saj. Administratori i Shoqërisë ka të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer çdo veprim dhe akt në kuadër të aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 18: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë brenda kompetencave të parashikuara në Statut apo/dhe në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
3. Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë;
4. Jep urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos saksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
5. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
6. Përgatisin dhe nënshkruajnë pasqyrat financiare, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
7. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
8. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
9. Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
10. Kryejnë detyra të tjera të përcaktuar në ligj dhe në statut, të zbatojnë vendimet e marra nga asambleja e përgjithshme.



Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 20: Përgjegjësitë e Administratorit

20.1 Administratori është personalisht përgjegjës, kundrejt Shoqërisë dhe palëve të treta, në rast të shkeljes së ligjit dhe statutit ose veprimeve të tjera të paligjshme të kryera me dashje gjatë administrimit të tij. Administratori dhe ortakët që kanë ndërmarrë veprime ose kanë bërë marrëveshje të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme, janë përgjegjës për pasojat që rezultojnë dhe janë personalisht përgjegjës për to.

20.2 Nëse administratori sillet në kundërshtim me detyrat dhe standardet profesionale, ai duhet të dëmshpërblejë Shoqërinë dhe të rimbursojnë të gjithë shumën që ata dhe personat e lidhur me ta kanë bërë nga një sjellje e tillë.

TITULLI IV

VITI FINANCIAR, EKSPERTET

Neni 21: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në "Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 22: Ekspertët

22.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ortakët e shoqërisë.

22.2 Në përfundim të kontrollit dhe pas plotësimit të kësaj kërkesë, eksperti kontabël përgatit pasqyrat financiare vjetore ose një raport periodik, i cili duhet t'u dërgohet në kohë aksionerëve për miratim.

TITULLI V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË


Neni 23: Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) Me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) Me vendim të gjykatës.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Neni 24: Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi – ndarja



Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 25: Të ndryshme

25.1 Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut. gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

25.2 Shoqëria "SONDATA" SHPK regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 35 e ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", autorizohet administratori i shoqërisë Z. Etiev Mane ose çdo përfaqësues i posacem i caktuar sipas tij, për kryerjen e të gjitha procedurave të nevojshme me qëllim regjistrimin e shoqërisë në QKB

25.3 Statuti u hartua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë juridike, të cilat depozitohen dhe disponohen në dosjen e Shoqërisë.

Tiranë, 09/09/2025

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

"SONDATA" SHPK

ETIEV MANE

Etiev Mane

